

STATUTI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“SL GERMAN SKELA ” Sh.p.k.

Sot më datë 17/ 04/ 2023, ne themeluesit, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin “SL GERMAN SKELA ” SH.P.K.

Themeluesit e shoqërisë janë:

- Z.Argi Llanaj, banues në adresën: Rruga Frosina Plaku, Tiranë
- Z.Ernest Llana, banues ne adresen: Rezidenca Kodra e Diellit 2, Tiranë

KAPITULLI I
FORMA, EMËRTIMI, OBJEKTI, SELIA, KOHËZGJATJA

Neni 1 – Forma

- 1.1. Shoqëria “SL GERMAN SKELA” Sh.p.k. (në vijim “Shoqëria”) krijohet në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, dhe veprimtaria e saj rregullohet me anë të këtij Statuti dhe Aktit të Themelimit.
- 1.2. Shoqëria vepron sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.
- 1.3. Akti i Themelimit dhe Statuti janë në përputhje me legjislacionin shqiptar që ka karakter të detyrueshëm, ndërsa çështjet që nuk janë shprehimisht të parashikuara në to, plotësohen nga legjislacioni shqiptar.

Neni 2 – Emërtimi

Emërtimi i Shoqërisë është “SL GERMAN SKELA” Sh.p.k.

Neni 3 – Objekti i shoqërisë

- 3.1. Shoqëria ka si objekt të saj kryerjen e aktiviteteve tregtare në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.
- 3.2. Në mënyrë më të detajuar Shoqëria ka si objekt:
 - Aktivitet në fushën ndërtimit.
 - Dhënie me qera, montim, çmontim, mirëmbajtje riparime dhe pajisje skelerie.
 - Import eksport pajisje ndërtimi dhe skelerie.
 - Lyerje, rinovime dhe mirëmbajtje godinash.
 - Projektim, ndërtim, instalim dhe mirëmbajtje pikave të karburantit, lavazhe, servise, aktivitete ndihmëse, mirëmbajtje dhe restaurime.
 - Import-Eksport, shitje me shumicë e pakicë, materiale elektrike, ndërtimi, industriale, hidroteknike, kimikate, karburante e lënde djegëse, lubrifikante, pjesë këmbimi auto, pajisje teknologjike mjedisore, makineri e pajisje të çdo lloji.
 - Prodhim konstruksione metalike të të gjitha llojeve, prodhim skeleri për



punime fasadash, për armatura, pista, stadione, podjume, koncerte, gara etj, të ngjashme.

- Punime gërmimi, sistemime e tarracime terenesh, punime ne toke te germuar
- Mirembajtje, riparime makineri dhe paisje skelerie. (mirembajtja dhe riparimi i Aktiveve)

- 3.3. Shoqëria mund të kryejë çdo veprimtari tregtare që, sipas opinionit të organit administrativ, janë të nevojshme ose të dobishme për arritjen e objektivit të shoqërisë, ndër të cilat operacione imobiliare, mobiliare dhe financiare, duke përfshirë dhënien e garancive reale dhe/ose personale, të dhëna në interes të shoqërisë, për detyrime si të vetat dhe të të tretëve; janë shprehimisht të përjashtuara aktivitetet që në bazë të ligjit në fuqi janë kompetencë ekskluzive e urdherave apo kolegjeve profesionale ose të një kategorie të caktuar operatorësh për të cilët sistemi kërkon kualifikime specifike, autorizime, licensa ose cfaredolloj gjëje tjetër të ngjashme, pa cënuar rastet kur Shoqëria i ka këto kualifikime, autorizime apo licensa.

Neni 4 – Selia

- 4.1. Selia ligjore e Shoqërisë është në adresën rruga e Kavajes, Nr.pasurie 7/244-N49, ZK 8220, Tirane.
- 4.2. Transferimi i selisë së Shoqërisë në një vend tjetër bëhet me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme.
- 4.3. Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë hapjen e filialeve, degëve dhe përfaqësive të Shoqërisë në qytete të tjera të Shqipërisë.

Neni 5 – Kohëzgjatja e veprimtarisë

- 5.1. Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë me një afat të pacaktuar.
- 5.2. Shoqëria mund të prishet përpara këtij afati ose mund të zgjasë kohëzgjatjen e saj me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

KAPITULLI II KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, NDARJA DHE TRANSFERIMI I KUOTAVE

Neni 6 – Kapitali themeltar

- 6.1. Kapitali themeltar i Shoqërisë është në vlerën 300,000 (treqind mijë) Lekë.
- 6.2. Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 2 kuota, me vlerë nominale të një kuote prej 150,000(njëqind e pesëdhjetë mijë) Lekë.
- 6.3. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:



1. Ortaku themelues Z.Ernest Llana, zotërues i 50 % (pesëdhjetë përqind) të kapitalit (kuotave) të shoqërisë, me vlerë 150,000(njëqind e pesëdhjetë mijë) Lekë.
2. Ortaku themelues Z.Argi Llana, zotërues i 50 % (pesëdhjetë përqind) të kapitalit (kuotave) të shoqërisë, me vlerë 150,000(njëqind e pesëdhjetë mijë) Lekë.

Neni 7 - Kontributet

- 7.1 Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme / të paluajtshme apo të drejta)

Neni 8 – Rritja e kapitalit themeltar

- 8.1 Kapitali themeltar mund të rritet pa kufi në çdo moment, një ose disa herë, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.
- 8.2 Në rast vendimi për rritjen e kapitalit, të gjithë ortakët kanë të drejtën të nënshkruajnë rritjen në raport me pjesët e kapitalit të zotëruara. Në rast se disa nga ortakët nuk e ushtrojnë këtë të drejtë, pjesët e tyre mund të nënshkruhen nga ortakët e tjerë proporcionalisht me pjesët e kapitalit të zotëruara prej tyre.

Neni 9 – Zvogëlimi i kapitalit themeltar

- 9.1 Shoqëria mund të zvogëlojë kapitalin themeltar me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme. Në çdo rast kapitali themeltar nuk mund të zvogëlohet nën kufijtë e parashikuar nga ligji.
- 9.2 Zvogëlimi i kapitalit përballohet nga secili prej ortakëve në të njëjtën masë me pjesët e kapitalit të zotëruara prej tyre.

Neni 10 – Transferimi i kuotave

- 10.1 Kuotat janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve.
- 10.2 Në rast transferimi në çdo lloj forme, si me shpërblim ashtu edhe pa shpërblim në kuptimin më të gjerë të fjalës, duke përfshirë këtu edhe dhurimin në favor të subjekteve të tjerë të ndryshëm nga ortakët, kuotat duhet më parë t'i ofrohen në parablerje ortakëve të tjerë.
- 10.3 Në një rast të tillë ortaku që do të transferojë kuotën e tij duhet të njoftojë ortakët e tjerë, me letër rekomande me kthim përgjigje, mbi synimin për shitje, duke përcaktuar çmimin, kushtet, modalitetet, emrin e blerësit dhe afatet e transferimit. E drejta e parablerjes duhet gjithsesi t'i referohet të gjitha kuotave të ofruara për shitje.
- 10.4 Ortakët do të kenë në dispozicion 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga marrja e letrës rekomande, për t'i komunikuar ortakut që transferon kuotat, synimin e tyre për të ushtruar apo jo të drejtën e parablerjes. Në rast se ata nuk përgjigjen në afatin e caktuar, presumohet se kanë hequr dorë nga e drejta e tyre e

parablerjes.

- 10.5 Në rast se oferta pranohet nga disa ortakë, kuotat e ofruara nga ortaku që transferon kuotat, do të ndahen nga ortakët pranues, në të njëjtën masë me kuotat që ata zotërojnë, përveç rastit kur ka një marrëveshje të kundërt. Në asnjë rast, pranuesi i ofertës nuk mund të ushtrojë pjesërisht të drejtën e parablerjes.
- 10.6 Në rast se nuk ushtrohet e drejta e parablerjes, kuotat mund t'u transferohen të tretëve plotësisht apo pjesërisht, me vendimin pro të Asamblesë së Përgjithshme.
- 10.7 Paragrafet nga 10.2 deri në 10.6 të këtij Statuti nuk do të aplikohen, dhe kuotat do të jenë lirisht të transferueshme në rast të: i) transferimit të kuotave për shkak trashëgimie; ii) transferimit të kuotave për një shoqëri të kontrolluar nga një prej ortakëve (do të kemi shoqëri të kontrolluar nëse ortaku i shoqërisë zotëron të paktën 51% (pesëdhjetë e një përqind) të kapitalit themeltar); iii) transferimit të kuotave për paraardhës ose pasardhës të drejtperdrejtë ose bashkeshort/e të ortakëve.
- 10.8 Njoftimet e parashikuara në këtë nen duhet ti drejtohen edhe Shoqërisë.

KAPITULLI III

ASAMBLEJA, ADMINISTRATORËT DHE EKSPERTI KONTABËL

Neni 11 – Asambleja e Përgjithshme dhe kompetencat e saj

- 11.1 Organi vendim-marrës i Shoqërisë është Asambleja e Përgjithshme.
- 11.2 Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për çështjet vijuese: ndryshimet e statutit, emërimi dhe shkarkimi i administratorëve, ekspertëve kontabël e likuidatorëve, zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit, transferimi i kuotave, shpërndarja e fitimeve, riorganizimi dhe prishja e shoqërisë, miratimi i bilancit dhe për çdo vendim tjetër parashikuar nga ky Statut apo nga legjislacioni përkatës.

Neni 12 – E drejta e pjesëmarrjes dhe e votës

- 12.1 Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në Asamblenë e Përgjithshme, të paraqesë mendimin e tij dhe të japë aq vota sa është numri i kuotave që ai zotëron.
- 12.2 Çdo ortak ka të drejtë të përfaqësohet nga një person tjetër jo-ortak, i pajisur me prokurë me shkrim, me anën e së cilës mund të japë votën e tij.
- 12.3 Ortaku nuk mund të lëshojë prokurë për votim për një pjesë të kapitalit që zotëron, në qoftë se voton personalisht për pjesën e mbetur.



Neni 13 – Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme, Kuorumi dhe Vendimet

- 13.1 Asambleja e Përgjithshme thirret të paktën një herë në vit, brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar për miratimin e bilancit, të raportit të Administratorit/ëve, ekspertit kontabël si dhe të inventarit.
- 13.2 Për më tepër, Asambleja mund të thirret në çdo moment nga një prej Administratorëve si dhe prej njërit ose disa ortakëve që përfaqësojnë të paktën 5% (pesë përqind) të kapitalit themeltar. Asambleja duhet të thirret nëpërmjet njoftimit me letër rekomande me kthim përgjigje që duhet t'u dërgohet ortakëve – në adresën që rezulton në Librin e Ortakëve – dhe ekspertit kontabël (nëse është emëruar), të paktën 7 (shtatë) ditë përpara mbledhjes së Asamblesë. Thirrja duhet të përmbajë informacion mbi llojin e Asamblesë, mbi çështjet që do të trajtohen dhe për të cilat do të merret vendim, mbi vendin, orën dhe datën e thirrjes së parë dhe të dytë.
- 13.3 Asambleja mund të thirret edhe jashtë selisë së Shoqërisë, si në Gjermani ose në Shqipëri.
- 13.4 Në rast se Asambleja e Përgjithshme nuk mbledhet me thirrjen e parë për mungesën e kuoromit të parashikuar në pikën 13.7 të këtij Statuti, Asambleja e Përgjithshme do të thirret brenda 30 (tridhjetë) ditësh me të njëjtin rend dite.
- 13.5 Mbledhjet e Asamblesë mund të mbahen edhe nëpërmjet telekonferencës dhe videokonferencës, me kusht që të gjithë pjesëmarrësit të mund të identifikohen dhe t'u lejohet atyre të ndjekin diskutimin dhe të ndërhyjnë në momentin e trajtimit të çështjeve në rend të ditës; pasi të jenë verifikuar këto kërkesa që duhet të rezultojnë në procesverbalin e mbledhjes, Asambleja konsiderohet e mbajtur në vendin ku ndodhet Kryetari në të cilin duhet të ndodhet edhe Sekretari i mbledhjes.
- 13.6 Asambleja do të konsiderohet si e thirrur dhe e mbajtur rregullisht edhe pa respektimin e formaliteteve të njoftimit, në rast se janë të pranishëm ortakët që përfaqësojnë të tërë kapitalin themeltar.
- 13.7 Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme, për të cilat kërkohet një shumicë e thjeshtë, janë të vlefshme nëse janë të pranishëm ortakët me të drejtë vote që zotërojnë më shumë se 50% (pesëdhjetë përqind) të kapitalit themeltar. Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme që kërkojnë një shumicë të cilësuar, janë të vlefshme nëse janë të pranishëm ortakët me të drejtë vote që zotërojnë të paktën $\frac{3}{4}$ (tre të katërta) të të gjithë kapitalit themeltar.
- 13.8 Asambleja e Përgjithshme vendos ndryshimet e statutit, zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë, me votën pro të $\frac{3}{4}$ (tre të katërtat) e ortakëve të pranishëm. Në të gjitha rastet e tjera, Asambleja e Përgjithshme merr vendime në seance të zakonshme, me shumicë të thjeshtë votash të ortakëve të pranishëm ose të përfaqësuar.
- 13.9 Çdo Asamble drejtohet nga një ortak ose ndonjë person tjetër i caktuar nga vetë Asambleja. Për pasqyrimin e vendimit Asambleja emëron një Sekretar, që



mund të jetë edhe jo-ortak.

- 13.10 Vendimet e Asamblesë duhet të nënshkruhen nga Kryetari i Asamblesë dhe nga Sekretari.

Neni 14 – Administrimi

- 14.1 Shoqëria administrohet nga një ose më shumë Administratorë, të cilët do të qëndrojnë në detyrë deri në shkarkim apo dorëheqje ose për një periudhë për 5 vjet. Administratori do të konsiderohet i riemëruar në detyrë në rast se Asambleja e Përgjithshme nuk ka emëruar një Administrator të ri përpara përfundimit të mandatit të Administratorit.
- 14.2 Përfaqësimi ligjor i Shoqërisë i besohet Administratorit. Administratori do të ushtrojë të gjitha kompetencat ne perputhje me sa parashikohet në nenin 95 të Ligjit n. 9901 te dates 14.04.2008 “Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare” dhe me aktin e emërimit.
- 14.3 Gjithësesi do të jetë i nevojshëm autorizimi paraprak i ortakëve, me vendim që do të merret me votën pro të ortakëve që përfaqësojnë të paktën 51% (pesëdhjetë e një për qind) të kapitalit të shoqërisë, për përmbushjen e akteve në vijim:
- (i) marrjen e kredive, garancive dhe hapjen e kredive në përgjithësi pranë çdo instituti ose ndërmarrjeje kredie, me ose pa garanci, të cfarëdo vlere;
 - (ii) shitblerjen, kontributet dhe dhënien me qira të ndërmarrjeve ose degëve të ndërmarrjeve;
 - (iii) themelimin e shoqërive të çdo lloji, konsorciumeve dhe enteve kolektive të çdo lloji;
 - (iv) shitjen dhe blerjen e pjesëmarrjeve dhe interesave të cdo lloji;
 - (v) blerjen, shitjen dhe dhënien me qira të pasurive të luajtshme të regjistruara;
- 14.4 Administratori mund të emërojë përfaqësues të posaçëm për veprime apo kategori të caktuara veprimesh.
- 14.5 Personat e mëposhtëm caktohen si administratorë të shoqërisë “SL GERMAN SKELA” SHPK:

- (i) Z.Ernest Llana, atësia Perlat, i datëlindjes 30.07.1992, lindur në Tepelenë dhe banues në Tiranë, shtetas shqiptar, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i kartës së identitetit me nr personal J20730040D
- (ii) Z.Argi Llanaj, atësia Agim, i datëlindjes 09.10.1982, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, shtetas shqiptar, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i kartës së identitetit me nr personal I21009038E,

për një afat 5-vjecar nga momenti i regjistrimit të këtij fakti pranë Qendrës Kombetare të Biznesit.

- 14.6 Adminstratorët në mënyrë të veçantë kanë këto kompetenca:

- (i) do të drejtojë dhe të përfaqësojë Shoqërinë përsa i perket administrimit të



zakonshëm;

- (ii) do të nënshkruajë çdo marrëveshje në emër të Shoqërisë;
- (iii) do të hapë llogari në emër të Shoqërisë me cdo bankë që kryen aktivitet në Shqipëri ose jashtë saj, ose pranë çdo institucioni financiar dhe bankar të mundshëm për Shoqërinë;
- (iv) do të përgatisë të gjitha planet për marrjen e financimeve, do të nënshkruajë çdo kontratë huaje apo kontratë tjetër që parashikon një borxh të mundshëm për Shoqërinë.
- (v) do të urdhërojë dhe kryejë pagesa në emër të Shoqërisë duke nënshkruar dokumentet/instrumentet e pagesave.
- (vi) do të kujdeset për mbajtjen e saktë dhe të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të Shoqërisë.
- (vii) do të përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, ia paraqet për miratim Asamblesë së Përgjithshme.
- (viii) do të kryejë regjistrimet dhe publikimet e detyrueshme të të dhënave të Shoqërisë, sipas kërkesave të ligjit nr.9723, datë 3 Maj 2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit".
- (ix) Të kryejë detyra të tjera, të percaktuara në Ligjin për Shoqëritë Tregtare duke pasur parasysh në çdo rast të kufizimeve të parashikuara nga ky Statut, si dhe detyrat e dhena me Vendim të Asamblese së Përgjithshme.

14.7 Administratoret kanë të drejta nënshkrimi veç e veç, pa asnjë kufizim.

Neni 15 – Eksperti kontabël i autorizuar

- 15.1 Në rast se kërkohet nga ligji apo vendoset nga Asambleja e Përgjithshme, kontrolli i balanceve dhe librave kontabël të Shoqërisë mund t'i besohet një ose disa ekspertëve kontabël të autorizuar.
- 15.2 Eksperti kontabël i autorizuar mund të shkarkohet në cdo moment sipas mënyrave të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

KAPITULLI IV VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, SHPËRNDARJA E FITIMEVE

Neni 16 - Viti financiar dhe bilanci vjetor

- 16.1 Viti financiar fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor të secilit vit.
- 16.2 Viti i parë financiar fillon në datën e regjistrimit të Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe përfundon më 31 dhjetor të të njëjtit vit.
- 16.3 Bilancet vjetore, inventari, raportet e Administratorit dhe ekspertit kontabël të autorizuar miratohen nga Asambleja e Përgjithshme me shumicën e kërkuar nga Ligji n. 9901 të datës 14.04.2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare".



- 16.4 Miratimi i dokumentave që lidhen me vitin financiar duhet të bëhet brenda 6 (gjashtë) muajve që nga fundi i vitit financiar.

Neni 17 – Fitimet

- 17.1 Fitimet që rezultojnë nga bilanci vjetor, u shpërndahen ortakëve në proporcion me pjesët e kapitalit themeltar të zotëruara respektivisht.
- 17.2 Asambleja mund të vendosë ndër të tjera edhe zbritje të veçanta në favor të rezervave të jashtëzakonshme ose për qëllime të tjera apo dhe shtyrjen e shpërndarjes së fitimeve - plotësisht ose pjesërisht - për vitet financiare të ardhshme.

KAPITULLI V SHPËRNDARJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË

Neni 18 – Prishja

- 18.1 Shoqëria priset me përfundimin e afatit të parashikuar nga Statuti, ose përpara përfundimit në rastet e parashikuara nga ligji, ose me anë të një vendimi të Asamblesë së Përgjithshme, me shumicën e kërkuar për ndryshimin e Statutit të Shoqërisë.
- 18.2 Shoqëria nuk priset në rast të humbjes së zotësisë për të vepruar, vdekjes ose falimentimit të ortakëve.

Neni 19 – Likuidimi

- 19.1 Në rast prishjeje, Shoqëria duhet të likuidohet.
- 19.2 Për të administruar këtë procedurë, Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë likuidatorë, të cilët paraqesin raportet përfundimtare mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivitetit të Shoqërisë, mbi operacionet e likuidimit dhe mbi kohën e nevojshme për të përfunduar likuidimin.
- 19.3 Me përfundimin e procedurës së likuidimit, Asambleja e Përgjithshme do të vendosë mbi bilancin financiar përfundimtar, mbi punën e kryer nga likuiduesi dhe mbi përfundimin e procesit të likuidimit.
- 19.4 Pas pagimit të kreditorëve dhe mbledhjes së kredive, likuidatori do t'i shpërndajë të ardhurat përfundimtare të likuidimit tek ortakët, në proporcion me pjesët e kapitalit të zotëruara prej tyre në kapitalin themeltar.

Neni 20 - Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

- 20.1 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e këtij statuti dhe aktit të themelimit, si edhe ato që mund të lindin në përgjithësi midis ortakëve (përveç atyre që kanë të bëjnë me marrëdhëniet personale apo jashtë Shoqërisë) ose midis një apo më shumë ortakëve dhe Shoqërisë, do të zgjidhen në mënyrë miqësore dhe do të



diskutohen në mënyrë të drejtpërdrejtë ndërmjet palëve të interesuara.

- 20.2 Në rast se nuk arrihet në një zgjidhje miqësore të mosmarrëveshjeve, ato do t'i besohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 21 – Gjuha

- 21.1 Ky Statut është hartuar në 4 (katër) kopje në gjuhën shqipe.

* * *

ORTAKËT E SHOQERISE ME PËRGJEGJESI TË KUFIZUAR

“SL GERMAN SKELA” SHPK

Z.Argi Llanaj



Z.Ernest Llana

